

VENDIM
Nr. 662, datë 2.9.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 650, DATË 13.8.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHYRJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE, TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTUREORE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTUREORE, NË BASHKITË TIRANË DHE KURBIN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 650, datë 13.8.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, vlera “... 144 289 030 (njëqind e dyzet e katër milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 130 186 061 (njëqind e tridhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë ...”;
 - b) Në shkronjën “a”, të pikës 2, vlera “... 87 358 750 (tetëdhjetë e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë ...” zëvendësohet me vlerën “... 73 255 781 (shtatëdhjetë e tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë ...”.
2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama